

RAPORT TEKNIK

**"PUNIME TË NDRYSHME ME SINJALISTIKËN RRUGORE,
MIRËMBAJTJE TË SINJALISTIKËS EKZISTUESE, RRUGË NË
ZONAT URBANE TË TERRITORIT TË BASHKISË KRUJË".**



TIRANË 2026

HYRJE

1.1-Të përgjithshme

Kruja ndodhet rreth 30 km në veri të qytetit të Tiranës. Shtrihet rreth kuotës 600m mbi nivelin e detit, është krejtësisht zonë kodrinore e malore, me pjerrësi të terrenit 10-35% me drejtim lindje-perendim. Në afërsi të saj ka disa kodra të vogla me lartësi 80-120m mbi nivelin e detit.

Bashkia Krujë përbëhet nga 5 njësi të tjeraadministrative:

Njësia Administrative Fushë Krujë

Njësia Administrative Thumanë

Njësia Administrative Bubq

Njësia Administrative Nikël

Njësia Administrative Cudhi

Rritja e ritmeve të zhvillimit në vendin tonë, dhe atij turistik në veçanti, kërkojnë investime të vazhdueshme si për përmirësimin e rrjetit rrugor ekzistues, po ashtu edhe të ndërtimit të rrugëve të reja apo disiplinimin e trafikut, për t'iu përgjigjur trafikut gjithmonë në rritje, ku problemi kryesor është ai i parandalimit të aksidenteve rrugore, sedomos në zonat e banuara dhe në zonat e reja të Rindërtimit.

Shoqëria projektuese (konsulente) "Erald G" shpk në bazë të termave të referencës (detyrës së projektimit), ka kryer studim-projektimin e këtij projekti për vendosjen e sinjalistikës, ka kaluar të gjitha fazat sipas programit të hartuar, duke filluar nga:

- Projekt idea
- Takime në Bashkinë Krujë

Projekti përmban:

1. Studimin e Projekt Idesë.
2. Studimin e Ambjentit.
3. Relacionin teknik që përmban një përshkrim të përgjithshëm për zonën, të dhëna mbi gjendjen ekzistuese të territorit të rrugës e rajonit përreth, përshkrimin mbi hartimin e projektit, llogaritjet e infrastrukturës, llogaritjet konstruktive, etj.
4. Specifikimet teknike.
5. Vizatimet e punës si: planimetrinë e përgjithshme të vendosjes sinjalistikës dhe të tabelave rrugore e vizimeve rrugore, detajet e kangjella trotuari etj.
6. Preventivin për rikonstruksionin e objektit.

Si shoqëri konsulente për hartimin e projektit jemi bazuar tek standartet dhe kushtet teknike shqiptare (keto kushte teknike shtrihen në studimin dhe projektimin e rrugëve).

1.2-Kushtet klimaterike

Në nënzonën mesdhetare jugore ndryshimi ditor i temperaturës shkon nga një minimum rreth agimit, në një maksimum nga 1 deri 3 orë mbasi dielli ka aritur në zenith, mbas të cilës ka një rënje të vazhdueshme gjatë natës deri në agim.

Temperatura mesatare ditore është mesatarja e temperaturës maksimale dhe minimale dhe normalisht është brenda kufirit të mesatares të vertetë që regjistrohet në mënyrë të vazhdueshme

Temperatura është matur në gradë Celsius (°C). Nga vërtetimet e deritanishme rezulton se maksimumi absolut i temperaturës së ajrit është 39.5 gradë. Në Shqipëri në shtresën e ajrit që është 2m larg sipërfaqes së tokës konstatohet një amplitudë e lartë termike prej 68.2 gradë, kjo është një vlefë e ndjeshme por gjithnjë karakterizuese për vendet mesdhetare, me një reliev të thyer siç është Kruja. Temperatura mesatare vjetore në Krujë është 15.3°C. Temperatura mesatare e janarit 5.8°C, e korrikut 26.6°C, temperatura absolute më e ulët në Krujë është -13°C, më e larta absolute 38.1°C. Reshjet mesatare vjetore 1618 mm për Krujë. Kjo zonë karakterizohet nga diferenca të mëdha intensitetesh reshesh.

Hidrologjia e krahinës së Krujës (ku përfshihet edhe Lagja nën ambulancë), varet së pari nga klima, së dyti nga topografia dhe gjeologjia. Faktorët klimatikë të një rëndësie parësore janë reshjet dhe mënyra e perhapjes së tyre, lagështia, temperatura dhe era, të cilat ndikojnë në avullimin dhe transpirimin.

Faktorët klimatikë të cilët janë marrë në konsideratë në analizë përfshijnë:

- Temperatura e ajrit,
- reshjet dhe analiza e tyre,
- bora dhe
- era.

Të dhënat që mbështesin këtë analizë janë marrë nga vendmatjet të zgjedhur dhe janë përmbledhur në tabelën 2.1 .

Regjistrimet klimatike nga stacionet klimatologjike mund të konsiderohen përfaqësuese të kushteve të pritura në Lagjen nën ambulancë, Krujë. Statistika klimatike të publikuara për periudhën nga 1942 janë përmbledhur në tabelë.

1.3.Popullsia

Të gjitha të dhënat mbi popullsinë e Krujës u dhanë nga Bashkia Krujë dhe në detyrën e projektimit. Popullsia e bashkisë Krujë deri në vitin 2020 nga të dhënat e

Bashkisë është rreth 80000 banorë. Studiusit demografë japin të dhëna të përafërta me ato të Bashkisë.

1.4. Ekonomia

Kruja renditet ne qendrat me nje zhvillim te mire ekonomik, historik, tregtare te vendit. Jo vetem Kruja, por i gjithë rrethi ne teresi ka luajtur historikisht nje rol shume te rendesishem ne zhvillimin ekonomik te krejt vendit.

Ne kete zone jane te mundshme per t'u zhvilluar te gjitha aktivitetet ekonomike. Megjithate midis tyre vlen te veçohen sektore te tille si turizmi, industria e cimentos, e mobilerise, me pak ekonomia bujqesore.

B.SHTRIRJA GJEOGRAFIKE E OBJEKTIT/ VENDOSJA E SINJALISTIKËS

Kruja renditet ne qendrat me trafik e sistem rrugësh mjaft të ngarkuar, ku në zona të caktuara të tij ka një numër të konsiderueshëm aksesh rrugore.

Mungesa e sinjalistikës ekzistuese (për mungesë fondesh të mjaftueshme investimesh apo dëmtime e vjedhje të sinjalistikës) si edhe shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor në shumë raste brenda territorit të bashkisë Krujë ka rezultuar fatale, me pasojë humbjen e jetës së kalimtarëve e këmbësorëve të ndryshëm.

Në shumë raste të tjera, edhe pse sinjalistika rrugore nuk mungon, ka patur shkelje të konsiderueshme të rregullave të qarkullimit rrugor, kryesisht me tejkalim shpejtësie mbi normat e lejuara, dëmtime të akseve rrugore rurale si pasojë e shfrytëzimit të tyre nga mjete të tonazhit të madh, kaos në qarkullim e qendrim mjeteve dhe parkime për mungesë sinjalistike.

Duke marrë në konsideratë numrin gjithmonë e në rritje të popullsisë në qendrat e banuara por edhe në zonat rurale, e për pasojë rritjen e numrit të mjeteve rrugore, mbetet detyrë parësore disiplinimi i trafikur pranë akseve kryesore të këtyre qendrave të banuara dhe zonave rurale. Për këtë qëllim bashkia Krujë ka hartuar projekt-preventivin për punime sinjalistike në territorin e bashkisë Krujë, i cili parashikon:

*Furnizimin e vendosjen e tabelave rrugore shoqëruar me sinjalistikën përkatëse horizontale dhe konkretisht:

-Disiplinimin e hyrje-daljeve të rrugëve rurale që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me akset kryesore nacionale, me anë të vendosjes së tabelave paralajmëruese dhe detyruese (të patrajuara në projektet e mëparshme).

-Disiplinimin e hyrje-daljeve në zonat urbane, kryesisht me tabelat paralajmëruese dhe të rrezikut. (të patrajuara në projektet e mëparshme).

-Vendojen e tabelave rrugore që dispijlojnë tonazhin e mjeteve rrugore. (të patrajuara në projektet e mëparshme).

-Kryerjen e vizimeve horizontale për akset rrugore, parkimet, kalimet për kalimtarët etj.

-Vendojen e parrakeve metalik në zonat me rrezik aksidentesh pranë shkollave.

I gjithë dokumentacioni përkatës, vendet e vendosjes së tyre, mënyra e vendosjes, tabela e sinjalistikës etj jepen në dokumentat shoqëruese të projektit.

Realizimi i këtij projekti si dhe i projekteve në vijim do të përmirësojë ndjeshëm qarkullimin rrugor në bashkinë Krujë, do të minimizojë aksidentet rrugore dhe do të

lehtësojë dukshëm lëvizjen e kalimtarëve dhe nxënësve dhe personave me aftësi ndryshe si edhe do të mbrojë akset rrugore rurale nga dëmtimi i tyre si pasojë e kalimin në to i mjeteve me tonazh mbi atë të llogaritur në projektim.

*Në shumë raste të tjera, edhe pse sinjalistika rrugore nuk mungon, ka patur shkelje të konsiderueshme të rregullave të qarkullimit rrugor, kryesisht me tejkalim shpejtësie mbi normat e lejuara.

Duke marrë në konsideratë numrin gjithmonë e në rritje të popullsisë në qendrat e banuara por edhe në zonat e reja për Rindërtim, mbetet detyrë parësore disiplinimi i trafikut pranë akseve kryesore të këtyre qendraver të banuara. Për këtë qëllim bashkia Krujë ka parashikuar në projekt-preventivin për punime sinjalistike në territorin e bashkisë Krujë përveç vendosjes së tabelave rrugore (kufizim tonazhi e shpejtësie), sinjalistikës horizontale e vertikale, edhe ndërtimin e disa kurrizave artificiale me asfaltobeton dhe vendosjen e kurrizave artificiale të gatshme:

Do të përdoren 3 tipa kurrizash:

1. Tipi 1 (gjerësi totale 5.0 m) do të përdoret në zonat urbane dhe pjesët e rrugëve nacionale
2. Tipi 2 (gjerësi totale 3.5 m) do të përdoret në rrugët kryesore të zonave urbane rurale
3. Tipi 3 (gjerësi totale 2.0 m) do të përdoret në rrugët lokale të zonave urbane kryesisht në qytetin e Krujës që karakterizohet nga reliev malor dhe rrugica të ngushta.

Menyra e shpërndarjes së tyre është e përcaktuar në fletët e projektit, por pozicioni i sakt do të përcaktohet në vend duke respektuar kriteret teknike përkatëse.

- a) Në qytetin e Krujës do të vendosen rreth 21 copë kurriza asfaltobeton B=2m dhe B=3.5m, L=3.5-4m, t=10cm sipas pozicioneve apo toponimeve në fletët e projektit. **Tipi 2 & Tipi 3**

- b) Në njësinë administrative Fushe Krujë:

- Në rrugën e Vjetër të Laçit në qytetin Fushë Krujë, 1 copë kurriza asfaltobeton B=5m, L=8m, t=10cm. **Tipi 1**
- Në Unazën e Vogël në qendër Fushë Krujë, 3 copë kurriza asfaltobeton B=5m, L=8m, t=10cm. **Tipi 1**
- Në rrugën e Burgut Fushë Krujë ("Hoxhë Çela") në qytetin Fushë Krujë, 3 copë kurriza asfaltobeton B=3.5m, L=6m, t=10cm. **Tipi 2**
- Në rrugët e "Ura e Babajt" dhe "Hasanit" në fshatin Hasan, 3 copë kurriza asfaltobeton B=3.5m, L=4m, t=10cm. **Tipi 2**
- Në rrugët e "Larushk i Poshtëm" në fshatin Larushk, 4 copë kurriza asfaltobeton B=3.5 m, L=4m, t=10cm. **Tipi 2**

- Në rrugët e "Rezervave" në fshatin Halil, 1 copë kurriza asfaltobetoni $B=2.0\text{ m}$, $L=4\text{ m}$, $t=10\text{ cm}$. **Tipi 3**
- Në rrugën e "Larushk - Ura e Gjolës" në fshatin Arrameras, 2 copë kurriza asfaltobetoni $B=2.0\text{ m}$, $L=4\text{ m}$, $t=10\text{ cm}$. **Tipi 3**

c) Ne njesine administrative Thumanë:

- Në rrugën kryesore në fshatin Borizanë, 4 copë kurriza asfaltobetoni $B=3.5\text{ m}$, $L=7\text{ m}$, $t=10\text{ cm}$. **Tipi 2**
- Në rrugën hyrëse të fshatit Thumanë, 3 copë kurriza asfaltobetoni $B=2.0\text{ m}$, $L=5\text{ m}$, $t=10\text{ cm}$. **Tipi 3**

- Në rrugë të ndryshme (do të përcaktohen në vend gjatë zbatimit nga mbikëqyrësi, në bashkëpunim me projektuesin dhe specialistë të Qarkullimit Rrugor), në qendra të banuara në bashkinë Krujë.

- Vizimet me bojë bikomponente në këto kurriza artificiale asfaltobetoni.

-F.v e 50 copë kurriza artificiale të gatshme plastike (kryesisht në qytetet Krujë 7 cope, Fushë Krujë (Lagja Punetori 2 cope, rruga e Njesisë Administrative Fushë Krujë 1 cope dhe zonave të Rindërtimit Thumanë dhe Bubq sipas sasise dhe kerkesave, $50\text{ cm} \times 100\text{ cm}$, $h=5\text{ cm}$.

-F.v e sinjalistikës rrugore vertikale për këto kurriza artificiale.

-F.v e tabelave paralajmëruese për këmbësorët e kalimtarët.

-Vijëzime të ndryshme me bojë bikomponente, kryesisht në qytetet Krujë dhe Fushë Krujë.

PËR GRUPIN E PROJEKTIMIT

"ERALD-G" sh.p.k

ING. GËZIM ISLAMI